


Çfarë është mësimi i profesionit (zanatit)? 3 vendet e mësimit



Berufsfachschule:	Shkolla profesionale	Schulische Bildung:	Arsimimi shkollor
Lehrbetrieb:	Ndërmarrja për aftësim profesional	Betriebliche Bildung:	Arsimimi në ndërmarrje
Überbetriebliches Kurszentrum:	Qendra e kursit jashtë ndërmarrjes	Grundlegende Fertigkeiten:	Aftësitë themelore

Arsimimi bazë profesional (i quajtur edhe zanat) është arsimimë i përhapur në mesin e të rinjve në Zvicër. Është një përzierje e arsimimit profesional teorik dhe praktik dhe përfundon me një diplomë, e cila është e njohur dhe e vlerësuar lartë në mbarë Zvicrën. Diplomimi njihet me këta emra:

- pas një shkollimi 2-vjeçar: EBA (Atesti Federal i Profesionit)
- pas një shkollimi 3- ose 4-vjeçar: EFZ (Certifikata Federale e Aftësimit)

Nëse ju për shembull vijoni një arsimim me Certifikatë Federale të Aftësimit, mësoni në tri vende mësimi:

1. Ndërmarrja për aftësim profesional (ndërmarrje tregtie, shtëpi mallrash, spital, ndërmarrje ndërtimi, restorant, garazh automobilash dhe shumë të tjera)

Në ndërmarrjen për mësimin e profesionit bëni bashkë me të tjerët punë të përditshme dhe në fillim do të keni detyra më të lehta, e me vazhdimin e arsimimit edhe detyra më të sofistikuara. Njëkohësisht mësoni në mënyrë praktike ato që duhen ditur në profesionin përkatës (operacione manuale, punë me vegla dhe makina, shërbim ndaj klientëve etj.). Gjatë kësaj kohe do të keni mbështetje dhe përkrahje të veçantë nga mësuesi ose mësuesi/ja juaj e profesionit dhe përkujdesje nga persona të tjerë (bashkëpunëtorë, shëgërtët e viteve të larta që mësojnë për Certifikatë Federale të Aftësimin).

Në ndërmarrje i kaloni 3-4 ditë në javë, për shembull prej të hënës deri të mërkurën dhe të premten. Meqenëse ju - prej fillimit dhe me arsimimin e vazhdueshëm - jeni produktiv në ndërmarrjen ku mësoni profesionin, merrni një rrogë për shëgert. Lartësia e rrogës ndryshon - varësisht nga profesioni dhe viti i shkollimit në profesion- midis 400,- dhe 1600,- franga në muaj. Ju keni të drejtë për 5 javë pushim vjetor.

2. Kurset jashtë ndërmarrjes

Ndërmarrjet të cilat nxjerrin prodhime të ngjashme dhe ofrojnë shërbime të ngjashme, kanë po ashtu teknika dhe metoda të ngjashme të punës. Secili profesion kërkon një mori të diturive dhe të shkathtësive praktike të caktuara. Këto shkathtësi mund t'i fitoni, përveç në ndërmarrje, po ashtu edhe në kurset jashtë ndërmarrjes. Kurset jashtë ndërmarrjes mund t'i ndiqni në formë njëditore ose për disa ditë gjatë vitit, zakonisht në një qendër rajonale të kurseve; kurset jashtë ndërmarrjes për ju janë falas.

3. Shkolla profesionale

Në shkollën profesionale mësoni 1 - 2 ditë në javë (8 deri 15 orë) njohuritë teorike që i përkasin profesionit tuaj dhe zgjeroni njohuritë tuaja në lëndët themelore si gjuhët, njohuritë e përgjithshme (politikë, drejtësi, edukatë shtetërore, kulturë, teknikë, ekonomi, financa dhe konsumi, marrëdhëniet dhe bashkëjetesa, sigurimet dhe shumë të tjera). Mësimi mbahet në shkollën të rajonit tuaj dhe është pa pagesë (kontribute për mjetet mësimore, ekskursione dhe të ngjashme janë gjithashtu të mundshme).

Përveç kësaj, ju mund të ndiqni mësimin profesional në klasa të veçanta, të pajisura enkas për këtë (punëtori, laborator, dhomat e kompjuterëve dhe të tjera). Në këto mësim të orientuara në praktikë mësoni pjesën profesionale të arsimimit. Në shkollën profesionale keni edhe detyra shtëpie dhe duhet të përsëritni mësimin në kohën e lirë. Përveç kësaj, ju përgatiteni edhe për provimet, në të cilat merrni nota; notat vlejné për diplomimin tuaj profesional.

Kush nuk mund t'i ndjekë sa duhet mësimet në shkollën profesionale, dhe në provime merr nota të pamjaftueshme, ka të drejtë në kurse mbështetëse.